



REPUBLICA E Kosovës / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIJSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njesia org. Org.Jedinita Org.Unit	<u>DMMU</u>	Nr. I Prot. Broj Prot. Prot.No	<u>5775-2/23</u>
Nr. I Faqjeve Br. Stranica No. Pages	<u>- 05 -</u>	Data: Datum: Date	<u>29.04.24</u>
PRISHTINË / A			No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	01.03.2024
REFERENC-Ë:	23/5775/MMPHI
PËR/ZA/TO:	“Agi Dani” Sh.p.k - Gjilan
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 23/5775/552/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në draft vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

- Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë “Agi Dani” Sh.p.k., Gjilan – për zgjerimin e shfrytëzimit të gurit gëlqeror në Strazh-Koretishtë, Novobërdë (zgjerim i fushës eksploatuese) në ngastrën kadastrale Nr. P-72403034-00218-0 në Z.K. në Koretishtë, Novobërdë.
- Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31, pika 1, 2, dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29. të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Kompania "Agi Dani" Sh.p.k - Gjilan pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: për zgjerimin e shfrytëzimit të gurit gëlqeror në Strazh-Koretishtë, Novobërdë (zgjerim i fushës eksploative) në ngastrën kadastrale Nr. P-72403034-00218-0 në Z.K. në Koretishtë, Novobërdë nën kushtet si vijon:

- Gjatë punës (procesit teknologjik) duhet të ndërmerren të gjitha masat për evitimin e ndotjes së mjedisit nga mbeturinat e ngurta, evitimin nga derdhja e vajrave të makinave, evitimin nga derdhja e karburanteve e posaçërisht gjatë furnizimit të makinave;
- Të bëhet sistemi për grumbullimin e ujërave nga sipërfaqet operationale, dhe të hapet kanali për rreth mihjes me qëllim të mbledhjes së ujërave atmosferike të ndotura dhe të orientohen në pusët sedimentuese për trajtimin e ujërave, në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor;
- Të rregullohen pajimet për trajtimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet operationale (pusët sedimentuese dhe seperatori i vajrave), në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor;

Faqe 2 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-209-32-307

<http://www.ks.gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks.gov.net



- Të vendosen pajimet adekuate për mbeturina të ngurta dhe lëngta;
- Bazuar në Ligjin e Ujërave Nr.04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Ndalohet veprimtaria e Kompanisë "Agi Dani" Sh.p.k., Gjilan – për zgjerimin e shfrytëzimit të gurit gëlqeror në Strazh-Koretishtë, Novobërdë (zgjerim i fushës eksploatuese) në ngastrën kadastrale Nr. P-72403034-00218-0 në Z.K. në Koretishtë, Novobërdë, në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Ndalohet shfrytëzimi i gurit gëlqeror brenda dyqind (200) metra prej ndonjë pende ose rezervuari
- Në kohëra të nxehta të bëhet spërkatja e rrugës (pjesa e pa asfaltuar), kohë pas kohe, me ujë, me qëllim të zvogëlimit të pluhurit gjatë transportit, gjithashtu kamionët gjatë transportit të gurit gëlqeror duhet të mbuloen me mbulesë adekuate;
- Pas shfrytëzimit të kryhet rikultivimi i zonës së shfrytëzuar duke iu përshtatur projektit për rikultivim;
- Të bëhet thurja e ngastrës me tel gjëmbor.
- Aplikuesi përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga Kompania "Agi Dani" Sh.p.k, Gjilan për zgjerimin e shfrytëzimit të gurit gëlqeror në Strazh-Koretishtë, Novobërdë (zgjerim i fushës eksploatuese) në ngastrën kadastrale Nr. P-72403034-00218-0 në Z.K. në Koretishtë, Novobërdë në Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqimit Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 te Ligjit për VNM 08/L-181.

Faqe 3 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar ish Pallati Mjedisor " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10000 Prishtinë, Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimi e të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 23/5775/1 - ZSP/ /24 datë: 01.03.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Komunës së Novobërdës
6. Divizionit për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPH



Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të
MMPH

2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31, pika 1, 2, dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndoije të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	DMMU
Nr. i Faqëve Ee Stranica No. Pages	-
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	5775-2/23
Datim: Date:	04.03.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave/Departament za Zaštitu Sredine i Voda
Department of Environment Protection and Waters

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	23/5775/552/DMMU				
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së				
NGA/OD/FROM:	Abdullah Pirçe, Kryesues i Komisionit për VNM				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje kërkesës të Kompanisë "Agi Dani" Sh.p.k Gjilan – për zgjerimin e shfrytëzimit të gurit gëlqeror në Strazh-Koretishtë, Novobërdë.				
Nr. i zyrës:	1517	Lokacioni:	Ish Pallati i Mediave,	Data:	01.03.2024
Br. kancelarije:		Kueni:	Rilindja Prishtinë,	Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input checked="" type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODCOVOR/NOTE AND RETURN					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

Kompania "Agi Dani" Sh.p.k Gjilan, ka aplikuar për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor me nr. prot. 23/5775/552/DMMU, të datë: 04.10.2023.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, raportit të VNM-së, dokumentacionit përcjellës, të kompanisë "Agi Dani" Sh.p.k. Gjilan – për zgjerimin e shfrytëzimit të gurit gëlqeror në Strazh-Koretishtë, Novobërdë (zgjerim i fushës eksploatuese) në ngastrën kadastrale Nr. P-72403034-00218-0 në Z.K. në Koretishtë, Novobërdë, me datën 25.10.2023 nga kompania është kërkuar plotësim dokumentacioni:

- Dëshmia për vlerën financiare investuese të projektit;
- Raporti i VNM-së duhet të hartonet duke u bazuar në ligjin e ri për VNM (Nr. 08/L-181)


Kompania në fjalë ka sjell dokumentat e kërkuar brenda afatit ligjor.

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, neni 16, është mbajtur debati publik, me datë 01.02.2024.

Në takimin e komisionit të VNM-së, është shqyrtuar kërkesën, raportin e VNM-së dhe dokumentet përcjellëse, pas mbajtjes së debatit publik.

Bazuar në nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, Komisioni për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i rekomandon Sekretarët të Përgjithshëm të MMPHI-së që Kompanisë "Agi Dani" Sh.p.k. nga Gjilani të i **Lëshohet Pëlqimi Mjedisor**, për zgjerimin e shfrytëzimit të gurit gëlqeror në Strazh-Koretishtë, Novobërdë (zgjerim i fushës eksploatuese) në ngastrën kadastrale Nr. P-72403034-00218-0 në Z.K. në Koretishtë, Novobërdë, nën kushtet si vijon:

- Gjatë punës (procesit teknologjik) duhet të ndërmerren të gjitha masat për evitimin e ndotjes së mjedisit nga mbeturinat e ngurta, evitimin nga derdhja e vajrave të makinave, evitimin nga derdhja e karburanteve të posaçërisht gjatë furnizimit të makinave;
- Të bëhet sistemi për grumbullimin e ujërave nga sipërfaqet operationale, dhe të hapet kanali për rreth mihjes me qëllim të mbledhjes së ujërave atmosferike të ndotura dhe të orientohen në pusët sedimentuese për trajtimin e ujërave, në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor;
- Të rregullohen pajimet për trajtimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet operationale (pusët sedimentuese dhe seperatori i vajrave), në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor;
- Të vendosen pajimet adekuate për mbeturina të ngurta dhe lëngta;
- Bazuar në Ligjin e Ujërave Nr.04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.



eksploatuere) në ngastrën kadastrale Nr. P-72403034-00218-0 në Z.K. në Koretishtë, Novobërdë, në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.

- Ndalohet shfrytëzimi i gurit gëlqeror brenda dyqind (200) metra prej ndonjë pende ose rezervuari
- Në kohëra të nxehta të bëhet spërkatja e rrugës (pjesa e pa asfaltuar), kohë pas kohe, me ujë, me qëllim të zvogëlimit të pluhurit gjatë transportit, gjithashtu kamionët gjatë transportit të gurit gëlqeror duhet të mbulohen me mbulesë adekuate;
- Pas shfrytëzimit të kryhet rikultivimi i zonës së shfrytëzuar duke iu përshtatur projektit për rikultivim;
- Të bëhet thurrja e ngastrës me tel gjëmbor.

Aplikuesi përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartëcekura, pëlqimi do të anulohet (merret).

Bashkëgjitur me mendim profesional e gjeni draft Vendimin

Vërejtje: Shqyrtimi i kërkesës ka tejkaluar afatin ligjor për shkak të ngarkesës së Komisionit dhe vëllimit të madh të aplikacioneve për VNM.

Komisioni:

Abdullah Pirçe, kryesues

Malsore Jonuzi, anëtare

Rizah Muçolli, anëtar

Musli Kozhani, anëtar

Sylejman Latifi, anëtar

